

Kushtet e Përgjithshme për Sigurimin e Jetës në Grup

Neni 1 - Dispozitat e Përgjithshme

1. Kushtet e Përgjithshme për Sigurimin e Jetës, në vazhdim Kushtet e Përgjithshme, janë pjesë përbërëse e kontratës për sigurimin e jetës.
2. Domethënia e disa fjalëve:
 - a. “Siguruesi” është kompania e sigurimit të jetës “Illyria Life” me të cilën kontraktohet sigurimi i jetës.
 - b. “Kontraktuesi i Sigurimit” është personi juridik, nga Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë ose OIK.
 - c. Kontraktuesi është i obliguar që rregullisht ta njoftojë Siguruesin mbi ndryshimet në grup (marrja në sigurim e anëtarëve të ri të grupit dhe largimi i atyre që lëshojnë grupin).
 - d. “Personi i Siguruar” është person fizik, jeta e të cilit është subjekt i sigurimit.
 - e. “Grup” do të thotë të gjithë personat, që kanë marrëdhënie të përbashkët me Kontraktuesin e Sigurimit. Siguruesi është i obliguar ti pranoj në sigurim të gjithë anëtarët e grupit me kushte të njëjta.
 - f. “Përfituesi” është personi të cilit i paguhet shuma e siguruar, në bazë të kontratës për sigurimin e jetës, me rastin e ndodhjes së rastit të siguruar - vdekje, ndërsa për rastet e tjera të siguruara, përfituesi është personi i siguruar.
3. Sipas këtyre Kushteve të Përgjithshme mund të sigurohen personat nga mosha 18 deri në 65 vjeç.

Neni 2 - Pyetësi Shëndetësor

1. Pyetësi Shëndetësor përmban pyetjet mbi rrethanat në bazë të cilave Siguruesi vlerëson rrezikun për marrjen në sigurim.
2. Pyetësi Shëndetësor është pjesë përbërëse e kontratës së sigurimit të jetës dhe për zyrtarizmin e kësaj kontrate mjafton që të dyja palët ta nënshkruajnë atë.

Neni 3 – Polica

1. Polica e sigurimit të jetës lëshohet nga Siguruesi në dy ekzemplar.
2. Në policë ceken të dhënat për Siguruesin, Personat e Siguruar, Kontraktuesin e Sigurimit, rastet e siguruara, fillimi dhe kohëzgjatja e sigurimit, shuma e siguruar, premia , mënyra e pagesës së premisë, Përfituesit për të gjitha rastet e siguruara, data e lëshimit të policës dhe nënshkrimi i autorizuar i Siguruesit.
3. Lista e të siguruarve mund të ndryshohet çdo muaj pasi Kontraktuesi ta bëjë kërkesën për ndryshime (heqje apo shtim të personave të siguruar) në policë.
4. Pjesë përbërëse e kontratës për sigurimin e jetës janë: Polica, Kushtet e Përgjithshme, kushtet tjera të cekura në policë.

Neni 4 - Fillimi dhe Përfundimi i Obligimeve të Siguruesit

1. Fillimi i kontratës për sigurimin e jetës, është ora 00:00 e datës e cila shënohet në policë si fillimi i sigurimit, dhe skadimi në ora 00:00 e datës që shënohet në policë si përfundim i sigurimit.
2. Obligimet e Siguruesit fillojnë në ora 00:00 e datës e cila shënohet në policë si fillimi i sigurimit me kusht që deri në atë kohë është paguar premia . Nëse premia nuk është paguar deri në datën e cila shënohet në policë si fillimi i sigurimit, obligimet e Siguruesit fillojnë në orën 00:00 të ditës së ardhshme kur premia të jetë paguar.

Neni 5 – Premia dhe Shuma e Siguruar

1. Lartësia e premisë dhe shumës së siguruar përcaktohet nga Siguruesi në bazë të kërkesave të përcaktuara në thirrjen publike të publikuar nga Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë, si dhe sipas sistemit tarifar të aplikueshëm, duke u bazuar në: gjininë e Personave të Siguruar dhe moshën mesatare të grupit të siguruar. Moshë e Personit të Siguruar përcaktohet si diferenca ndërmjet vitit kalendarik të fillimit të sigurimit dhe vitit të lindjes së Personit të Siguruar.
2. Për të gjithë grupin e siguruar zbatohet një normë unike primi. Kjo nënkupton që primi llogaritet kolektivisht dhe pa marrë parasysh moshën ose gjendjen shëndetësore të individit. Një strukturë e tillë pasqyron natyrën e sigurimit grupor dhe mundëson mbulim pa vlerësim mjekësor për personat (përfshirja automatike e të gjithë anëtarëve të OIK) të përfshirë në marrëveshjen grupore.

Neni 6 - Pagesa e Premisë

1. Kontraktuesi i Sigurimit ka për obligim të paguaj preminë e sigurimit sipas afateve të kontraktuara, dhe
2. Premia parapaguhet sipas afateve të kontraktuara.
3. Premia do të paguhet në baza gjashtëmujore sipas marrëveshjes me OIK.
4. Nëse ndodh vdekja e Personit të Siguruar dhe sipas marrëveshjes premia është kontraktuar në baza gjashtëmujore, atëherë në rast të vdekjes parapagimi i premisë nuk kthehet, nëse është llogaritur zbritja për atë mënyrë pagese.
5. Nëse premia është paguar edhe për muajt pas vdekjes, ndryshimi së bashku me shumën e siguruar bashkërisht i kthehet Përfituesit.
6. Primi mund të paguhet vetëm pasi të jetë zyrtarizuar pranimi i kërkesës për ndryshime, përkatësisht shtim të personave të siguruar në polica nga Siguruesi dhe të jetë lëshuar fatura e rregullt për pagesë.
7. Premia për një anëtar të grupit caktohet në baza mujore dhe është unik për të gjithë anëtarët e grupit. Llogaritet në bazë të moshës mesatare të grupit.
8. Norma e primit është e pandryshuar gjatë periudhës kontraktuese (një vjeçare) dhe mund të ndryshojë në rast të renovimit të kontratës për vitet pasuese.

Neni 7 - Pasojat e Mospagesës së Premisë

1. Nëse Kontraktuesi i Sigurimit nuk paguan preminë sipas afateve të kontraktuara,

Siguruesi ka obligim që Kontraktuesin e Sigurimit, me shkrim, ta ftojë që të kryen pagesën.

- a. Nëse Kontraktuesi i Sigurimit në vërejtjen e Siguruesit, e cila duhet të dorëzohet me letër përmes Email-it, nuk e paguan preminë brenda afatit, i cili nuk mund të jetë më i shkurt se një muaj, duke llogaritur datën e dorëzimit të Email-it, Siguruesi mundet të ndërpresë kontratën e sigurimit.

Neni 8 - Obligimet të Personit të Sigurimit

1. Personi i Siguruar ka obligim që me rastin e kontraktimit të sigurimit të jetës, Siguruesit t'i deklarojë të gjitha rrethanat e rëndësishme për vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të njohura për të, apo të cilat nuk kanë mundur të mbeten të panjohura për të.
2. Rrethanat me rëndësi për vlerësimet e rrezikut janë përgjigjet në pyetjet e shkruara në Pyetësin Shëndetësor.
3. Nëse Personi i Siguruar me qëllim ka dhënë informata të pasakta, apo me qëllim ka heshtur ndonjë rrethanë të rëndësishme, Siguruesi rezervon të drejtën që ta ndërpresë, refuzoj pranimin në sigurim.
4. Në rast të ndërprerjes së kontratës për shkak të arsyeve të cekura në pikën 3. të këtij neni, Siguruesi e mban preminë e paguar dhe ka të drejtë të kërkojë pagesë të premisë së sigurimit për periudhën e sigurimit deri në shkëputjen e kontratës.

Neni 9 - Obligimet e Siguruesit

1. Në rast të vdekjes së anëtarit të grupit gjatë kohëzgjatjes së sigurimit, Përfituesit të cekur në policë i paguhet:
 - a. 50% nga shuma e siguruar, nëse vdekja ka ndodhur në 6 mujorin e parë nga përfshirja në sigurim e atij anëtari të grupit
 - b. Shuma e siguruar, nëse vdekja ndodh pas 6 muajsh nga pranimi në sigurim të atij anëtari të grupit.
2. Me përjashtim nga paragrafi a. i pikës 1. të këtij neni, shuma e siguruar i paguhet tërësisht Përfituesit nëse:
 - a. Kontraktimi i sigurimit është bërë me kontroll paraprake mjekësor të atij anëtari të grupit.
 - b. Vdekja ka ndodhur si pasojë e aksidentit, në kuptim të Kushteve të Veçanta për Sigurimin Shtesë nga Aksidentet Personale.
 - c. Vdekja ka ndodhur si pasojë e shtatzënisë apo gjatë lindjes.

Neni 10 - Kufizimi i Përgjegjësi të Siguruesit

1. Përgjegjësitë e Siguruesit kufizohen në shumën e barabartë me rezervën matematikore të mbledhur nëse vdekja e Personit të Siguruar rezulton nga:
 - a. lufta
 - b. çfarëdo akti i cili në vete përmban karakteristika të terrorizmit
 - c. katastrofa nukleare

- d. pjesëmarrja në konflikte të armatosura, luftë qytetare, çrregullime, kryengritje apo trazira në anën e nxitësit të trazirave
 - e. kryen veprimtari në cilësi të pilotit ushtarak, pilotit të helikopterit apo pilotit special (p.sh. fluturues me fluturake me/pa motor, drejtues balloni, kërcyes me parashutë)
 - f. marrja me sporte ekstreme (p.sh. alpinizëm, zhytje dhe të ngjashme)
 - g. pjesëmarrja në gara në vozitje apo trajnime në automjetet për drejtim në tokë, ajër apo ujë
2. Si përjashtim nga udhëzimet nga paragrafët e., f., g., e pikës 1. të këtij neni, Siguruesi kompenson shumën e plotë të siguruar nëse në policë është kalkuluar dhe evidentuar primi shtesë për sigurim nga rreziqet e veçanta.

Neni 11 - Përjashtimet nga Përgjegjësitë e Siguruesit

1. Të përjashtuara janë të gjitha përgjegjësitë e Siguruesit nëse aksidenti ka ndodhur si pasojë e rrethanave në vazhdim:
- a. për shkak të tërmetit
 - b. gjatë drejtimit të automjeteve për vozitje në tokë, ajër apo ujë pa leje zyrtare nga autoriteti kompetent, e cila i jep autorizim drejtimi me atë lloj dhe markë të automjetit. Konsiderohet se Personi i Siguruar posedon leje zyrtare kur gjatë përgatitjes së provimit merr drejtimin me mbikëqyrje të personit zyrtar profesional.
 - c. nëse Kontraktuesi i Sigurimit, Personi i Siguruar apo Përfituesi i sigurimit me qëllim ka shkaktuar aksidentin me rastin e përgatitjes, tentimit apo kryerjes së veprës penale me paramendim, dhe me rastin e ikjes pas aktit të tillë.
 - d. nëse dëshmohet ndikimi i narkotikëve apo gjendjes së dehjes së Personit të Siguruar. Konsiderohet se Personi i Siguruar është në gjendje të dehur nëse konstatohet prania e alkoolit në gjak më shumë se 10,8 mil. mol (0.50 promil) tek drejtuesi, dhe tek të siguruarit tjerë më shumë se 21.6 mil. mol (1.00 promil).
2. Kontrata për sigurim konsiderohet e pavlefshme nëse në momentin e kontraktimit ka ndodhur rasti i siguruar apo ka qenë duke ndodhur ose ka qenë e sigurt se do të ndodhë ose nëse atëherë ka pushuar mundësia që ajo të ndodhë. Në këto raste primi i paguar nuk i kthehet Kontraktuesit.

Neni 12 - Vetëvrasja e të Siguruarit

1. Vetëvrasja nuk mbulohet me kontratën për sigurim e jetës, nëse ndodh në dy vitet e para të sigurimit. Pas vitit të dytë të sigurimit plotësisht mbulohet me sigurim.

Neni 13 - Përfituesi i Sigurimit

1. Kontraktuesi i Sigurimit të Jetës mundet që në kontratë apo më vonë me mjete juridike, por edhe me testament të caktojë Përfituesin e policës.
2. Përfituesi nuk duhet të caktohet me emër domosdoshmërisht. Mjafton që shënimet për caktimin e tij të janë të mbajtura. Kur për përfitues janë të caktuar fëmijët apo trashëgimtarët, përfitimi ju takon edhe atyre të lindur më vonë, deri sa përfitimi i cili i

takon bashkëshortit/es i jepet personit i/e cila ka qenë në martesë me të siguruarin në momentin e vdekjes së tij/saj.

3. Nëse Përfituesi është person i moshës jomadhore, shuma e siguruar do ti paguhet prindit të tij, respektivisht kujdestarit.
4. Shuma e siguruar e cila duhet ti paguhet Përfituesit nuk hyn në trashëgiminë e të siguruarit gjithashtu as në rastin kur për përfitues janë caktuar pasardhësit.
5. Në të gjitha rastet tjera të siguruara përjashtuar vdekjen, përfitues është personi i siguruar ose ndonjë person tjetër me autorizim.

Neni 14 - Raportimi i Rastit të Siguruar

1. Personi që kërkon kompensim në bazë të sigurimit të jetës obligohet që Siguruesit t'i dorëzojë kërkesën menjëherë pas ndodhjes së rastit të siguruar (max. deri në 7 ditë).
2. Krahas me kërkesë duhet të paraqitet edhe dokumentacioni në vazhdim:

a) Ne rast të vdekjes:

- Formulari Njoftimi i Rastit të Sigurimit
- polica e sigurimit të jetës;
- dëshmia për datëlindjen e të siguruarit;
- certifikata nga libri amëz i të vdekurve, nëse kemi të bëjmë me vdekje të Personit të Siguruar
- siguruesi ka të drejtë që si dokumentacion shtesë të kërkojë dëshmitë mjekësore, zyrtare dhe të tjera, të nevojshme për verifikimin e rastit të siguruar dhe lartësisë së kompensimit sipas bazës për sigurim.

b) Ne rast të aksidenteve personale:

- Përfituesi duhet të plotësojë me saktësinë e duhur formularin “Njoftimi i Rastit të Sigurimit” dhe t’ia dorëzojë atë Siguruesit bashkë me dokumentin origjinal të Policës së Sigurimit.

c) Ne rastet e diagnostikimit me sëmundje kritike:

- Kërkesa për përfitim duhet të paraqitet me shkrim dhe të shoqërohet me dokumentacionin përkatës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
 - raportet mjekësore dhe diagnozën nga specialisti përkatës;
 - dokumente hospitalizimi dhe/ose ndërhyrje kirurgjikale;
 - analiza laboratorike dhe imazherike (nëse kërkohen);
 - çdo dokument tjetër të kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga siguruesi.
- Siguruesi ka të drejtë të kërkojë informacione ose dokumente shtesë për verifikimin e kërkesës.
- Siguruesi shqyrton kërkesën në përputhje me kushtet e policës dhe përkufizimet e sëmundjeve të mbuluara.
- Siguruesi ka të drejtë të kërkojë:
 - ekzaminime mjekësore shtesë nga mjekë të caktuar prej tij;
 - mendim të dytë mjekësor;
 - verifikim të dokumentacionit të paraqitur.

3. Pas plotësimit të kërkesës me dokumentacionet e kërkuara si më lartë, siguruesi është i detyruar të trajtojë kërkesën brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh punës.

Neni 15 - Kompensimi i Shumës së Siguruar

1. Kur ndodh rasti i siguruar, Siguruesi është i obliguar që të paguaj shumën e plotë të siguruar të përcaktuar me kontratë në afat prej katërmëdhjetë ditësh, duke llogaritur ditën kur i Siguruari ka pranuar njoftimin për aprovimin të dëmit.

Neni 16 - Akumulimi i Kompensimit dhe Shumës së Siguruar

1. Në sigurimin e jetës Siguruesi i cili e ka paguar shumën e siguruar nuk mundet sipas asnjë baze juridike të ketë të drejtë në kompensim nga pala e tretë përgjegjëse për ndodhjen e rastit të siguruar.
2. Në rast të ndodhjes së vdekjes paguhet vetëm një shumë siguroese varësisht nëse vdekja është natyrore apo aksidentale.

Neni 17 - Deklaratat në Lidhje me Kontratën e Sigurimit

1. Gjatë periudhës së kohëzgjatjes së kontraktuar të sigurimit, të gjitha deklaratat të cilat kanë të bëjnë me kontratën e sigurimit, Kontraktuesi i Sigurimit ka për obligim të ia dorëzojë Siguruesit në formatin e shkruar në adresën e selisë të Siguruesit.
2. Në rast të ndërrimit të adresës, Kontraktuesi i Sigurimit e ka për obligim ta njoftojë Siguruesin dhe të ia dorëzojë adresën e re. Në të kundërtën të gjitha informatat e Siguruesit do të dorëzohen në adresën e fundit të njohur.
3. Të gjitha ndryshimet në policë mund të zbatohen vetëm me miratimin e Kontraktuesit të sigurimit.

Neni 18 - Shkëputja e Kontratës

1. Kontraktuesi i Sigurimit ka të drejtë të kërkojë shkëputjen e kontratës për sigurim. Kërkesa me shkrim duhet të dorëzohet së paku 30 ditë para arritjes së premisë.

Neni 19 - Duplikati i Policës

1. Policën e humbur Siguruesi e ndërron kur i dërgohet vendim i plotfuqishëm që origjinali i policës për sigurimin e jetës është humbur dhe ajo është cilësuar jo-valide.
2. Siguruesi mund ta caktojë që polica e humbur deri në shumën e caktuar të sigurimit të ndërrohet me duplikatin edhe pa vendim gjyqësor mbi humbjen.

Neni 20 - Kompetencat në Rast të Mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet në mes të Siguruesit dhe të siguruarit respektivisht të siguruarit në njërën anë dhe kompanisë në anën tjetër i zgjedh gjykata kompetente në Prishtinë.